URDHËR
Nr. 40, datë 12.3.2025

PËR MIRATIMIN E RREGULLOREVE MBI RREGULLAT E DETAJUARA PËR CERTIFIKIMIN DHE DEKLARIMIN E SISTEMEVE TË MENAXHIMIT TË TRAFIKUT AJROR/SHËRBIMEVE TË LUNDRIMIT AJROR DHE MBI PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE TEKNIKE DHE PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE PËR MIRATIMIN E ORGANIZATAVE TË PËRFSHIRA NË PROJEKTIMIN OSE PRODHIMIN E SISTEMEVE DHE PËRBËRËSVE TË MENAXHIMIT TË TRAFIKUT AJROR/SHËRBIMEVE TË LUNDRIMIT AJROR[1]

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 81, pika 2 dhe nenit 84, pika 3, të ligjit nr. 96, datë 23.7.2020, "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" dhe në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar dhe me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, "Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Mbi rregullat e detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror", sipas shtojcës I, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Miratimin e rregullores "Mbi përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin ose prodhimin e sistemeve dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror" sipas shtojcës II, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

SHTOJCA I

RREGULLORE
MBI RREGULLAT E DETAJUARA PËR CERTIFIKIMIN DHE DEKLARIMIN E SISTEMEVE TË MENAXHIMIT TË TRAFIKUT AJROR/SHËRBIMEVE TË LUNDRIMIT AJROR DHE PËRBËRËSVE TË MENAXHIMIT TË TRAFIKUT AJROR/SHËRBIMEVE TË LUNDRIMIT AJROR

Neni 1
Fushëveprimi dhe qëllimi

[1] Ky urdhër përafron pjesërisht rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2023/1768, të datës 14 korrik 2023 që përcakton rregullat e detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së nr. L 228, 15.9.2023 dhe rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2023/1769, të datës 12 shtator 2023 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin ose prodhimin e sistemeve dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror dhe që ndryshon rregulloren zbatuese (BE) 2023/203.

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat e përbashkëta teknike dhe procedurat administrative për certifikimin dhe deklarimin e përputhshmërisë së projektimit të sistemeve ATM/ANS dhe përbërësve ATM/ANS. Kjo rregullore përcakton rregullat për:

a) identifikimin e sistemeve ATM/ANS dhe përbërësve të ATM/ANS të cilat ose i nënshtrohen certifikimit, deklarimit ose deklaratës së pajtueshmërisë;

b) lëshimin e certifikatave për sistemet ATM/ANS dhe përbërësit e ATM/ANS;

c) lëshimin e deklaratave të përputhshmërisë së projektimit të sistemeve ATM/ANS dhe përbërësve ATM/ANS nga organizatat e përfshira në projektimin ose prodhimin e sistemeve ATM/ANS dhe përbërësve ATM/ANS dhe që janë miratuar në përputhje me rregulloren mbi përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin ose prodhimin e sistemeve dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të navigimit ajror, sipas shtojcës II bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren (BE) 2023/1769, për pasjen e privilegjeve për të lëshuar deklarata të tilla përputhshmërie;

d) lëshimin e deklarimeve të përputhshmërisë së sistemeve ATM/ANS dhe përbërësve ATM/ANS nga ofruesit e ATM/ANS të certifikuar në përputhje me urdhrin e ministrit nr. 193, datë 6.10.2022 "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre", i ndryshuar, ose nga organizatat e përfshira në projektimin ose prodhimin e tyre të miratuar në përputhje me rregulloren mbi përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin ose prodhimin e sistemeve dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të navigimit ajror, sipas shtojcës II bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren (BE) 2023/1769;

e) lëshimin e direktivave për pajisjet ATM/ANS nga Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 2

Përkufizimet

1. Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto përkufizime:

a) "Pajisje ATM/ANS" nënkupton përbërësit e ATM/ANS siç përkufizohen në nenin 3, pika 19 të VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, dhe sistemet ATM/ANS siç përkufizohen në nenin 3, pika 23 të asaj VKM-je, duke përjashtuar përbërësit në ajër, të cilët janë subjekt i urdhrit të ministrit nr. 57, datë 13.03.2024 "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për kërkesat e aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit" që përafron rregulloren (BE) nr. 748/2012;

b) "Direktivë për pajisjet ATM/ANS" nënkupton një dokument i lëshuar nga EASA dhe pranuar e publikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose, i cili përcakton veprimet që duhet të kryhen nga ofruesit e ATM/ANS në pajisjet ATM/ANS për të adresuar një gjendje rrezikshmërie dhe/ose të pasigurt që është identifikuar dhe për të rivendosur performancën dhe ndërveprueshmërinë e asaj pajisjeje ATM/ANS kur provat tregojnë se siguria, mbrojtja, performanca ose ndërveprueshmëria e asaj pajisjeje të veçantë mund të rrezikohet përndryshe;

c) "Rrjeti evropian i menaxhimit të trafikut ajror" nënkupton tërësinë e sistemeve, të listuara në pikën 3.1 të shtojcës VIII të VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, që mundëson ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror në Bashkimin Evropian, duke përfshirë ndërfaqet në kufijtë me vendet e tjera;

d) "Sistemi funksional" nënkupton një kombinim të procedurave, burimeve njerëzore dhe pajisjeve, duke përfshirë harduerin dhe softuerin, të organizuar për të kryer një funksion brenda kontekstit të ATM/ANS dhe funksioneve të tjera të rrjetit ATM.

e) "Agjencia" nënkupton Agjencinë e Bashkimit Evropian për Sigurinë në Operim.

Neni 3

Autoriteti kompetent

1. Autoriteti kompetent përgjegjës për lëshimin e certifikatave për pajisjet ATM/ANS siç përshkruhet në nenin 4, për pranimin e deklaratave të përputhshmërisë së projektimit të pajisjeve ATM/ANS siç

përshkruhet në nenin 5, dhe për mbikëqyrjen e certifikatës dhe deklaratave, do të jetë Agjencia. Kërkesat e përcaktuara në aneksin I janë kërkesat që Agjencia zbaton sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian. Autoriteti i Aviacionit Civil pranon certifikimet apo pranimet e deklarimeve të Agjencisë.

2. Autoriteti kompetent përgjegjës për mbikëqyrjen e deklaratës së pajtueshmërisë të lëshuar nga një ofrues ATM/ANS siç përshkruhet në nenin 6 do të jetë i njëjti autoritet kompetent si autoriteti përgjegjës për certifikimin dhe mbikëqyrjen e atij ofruesi të ATM/ANS.

Neni 4

Certifikimi i pajisjeve ATM/ANS

1. Pajisjet e mëposhtme ATM/ANS do të lëshohen me një certifikatë siç përcaktohet në aneksin II:

a) pajisjet që mbështesin komunikimet kontrollor-pilot;

b) pajisjet që mbështesin shërbimet e kontrollit të trafikut ajror (ATC) kur mundësojnë ndarjen e avionëve ose parandalimin e përplasjeve.

2. Certifikatën e përmendur në paragrafin 1 e lëshon Agjencia dhe kjo certifikatë do t'i vihet në dispozicion Autoritetit të Aviacionit Civil, kur pajisjet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni përdoren nga Ofruesi i Shërbimeve të Lundrimit Ajror, i cili është certifikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

3. Certifikata e përmendur në paragrafin 1 lëshohet për një kohëzgjatje të pakufizuar. Ajo mbetet e vlefshme për një kohë të pacaktuar, përveç rasteve kur:

a) mbajtësi i certifikatës nuk i përmbush më kërkesat e kësaj rregulloreje; ose

b) sa u përket pajisjeve ATM/ANS, nuk ka miratim të vlefshëm të organizatës, të lëshuar nga Autoriteti Kompetent në përputhje me rregulloren mbi përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin ose prodhimin e sistemeve dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të navigimit ajror, sipas shtojcës II bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren (BE) 2023/1769; ose

c) pajisja ATM/ANS nuk përputhet më me bazën e saj të certifikimit në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.CERT.025 të aneksit II; ose

d) certifikata është dorëzuar nga mbajtësi i saj ose është revokuar nga Autoriteti Kompetent siç përshkruhet në nenin 3 të kësaj rregulloreje.

Pas dorëzimit ose revokimit të certifikatës, nëse është lëshuar në formë letre, ajo i kthehet Autoritetit Kompetent pa vonesë.

Në këtë rast, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të njoftohet nga Ofruesi i Shërbimeve të Lundrimit Ajror, i cili është certifikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

4. Me përjashtim të paragrafit 1, pajisjet ATM/ANS që përdoren vetëm në një pjesë të kufizuar të hapësirës ajrore jashtë rajonit të ICAO EUR me volum të ulët trafiku, dhe ku ajo pjesë e hapësirës ajrore kufizohet vetëm me hapësirën ajrore nën përgjegjësinë e një vendi jashtë Bashkimit Evropian, nuk kërkohet që të lëshohet një certifikatë. Në një rast të tillë, pajisjet ATM/ANS do të lëshohen me një deklaratë përputhshmërie sipas nenit 6.

Neni 5

Deklarata e përputhshmërisë së projektimit të pajisjeve ATM/ANS

1. Pajisja e mëposhtme ATM/ANS kur gjeneron, merr dhe transmeton të dhëna dhe/ose sinjale në hapësirë me qëllim të sigurimit të lundrimit ajror të sigurt dhe të ndërveprueshëm do të lëshohet me një deklaratë përputhshmërie të projektimit siç përcaktohet në aneksin III:

a) pajisje që mbështesin komunikimet tokë-tokë;

b) pajisje që mbështesin lundrimin ose mbikëqyrjen.

2. Deklaratat e përputhshmërisë së projektimit lëshohen nga organizatat e përfshira në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS dhe të cilat janë miratuar në përputhje me rregulloren për përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin ose prodhimin e sistemeve dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të navigimit ajror, sipas shtojcës II bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren (BE) 2023/1769.

3. Deklaratat e përputhshmërisë së projektimit të pajisjeve ATM/ANS lëshohen për një kohëzgjatje të pakufizuar. Deklaratat mbeten të vlefshme nëse nuk janë çregjistruar siç përshkruhet në përputhje me pikën DPO.AR.C.015(g)(6) të aneksit I të rregullores mbi përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin ose prodhimin e

sistemeve dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të navigimit ajror, sipas shtojcës II bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren (BE) 2023/1769, si rezultat i një prej shkaqeve më poshtë:

a) pajisja ATM/ANS nuk është më në përputhje me specifikimet e detajuara që mundësojnë lëshimin e deklaratës;

b) lëshuesi i deklaratës nuk është më në përputhje me kërkesat e rregullores mbi përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin ose prodhimin e sistemeve dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të navigimit ajror, sipas shtojcës II bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren (BE) 2023/1769, ose miratimi i saj është dorëzuar, pezulluar ose revokuar;

c) pajisja ATM/ANS ka rezultuar se shkakton rrezik të papranueshëm ose performancë të papranueshme në shërbim;

d) organizata ka tërhequr deklaratën e përputhshmërisë së projektimit.

4. Me përjashtim të paragrafit 1, për pajisjet ATM/ANS që përdoren vetëm në një pjesë të kufizuar të hapësirës ajrore jashtë rajonit të ICAO EUR me volum të ulët trafiku, dhe ku ajo pjesë e hapësirës ajrore kufizohet vetëm me hapësirën ajrore nën përgjegjësinë e një vendi jashtë Bashkimit Evropian, nuk kërkohet të lëshohet një deklaratë e përputhshmërisë së projektimit. Në një rast të tillë, pajisjet ATM/ANS do të lëshohen me një deklaratë përputhshmërie në përputhje me nenin 6.

5. Për sa u përket pajisjeve ATM/ANS të Shërbimit Evropian të Mbulimit Gjeostacionar të Navigimit (EGNOS), deklarata e përputhshmërisë së projektimit siç përcaktohet në aneksin III të kësaj rregulloreje lëshohet nga Agjencia e Bashkimit Evropian për Programin Hapësinor (EUSPA) themeluar me Rregulloren (BE) 2021/696, e cila konsiderohet si një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve EGNOS.

6. Pikat ATM/ANS.EQMT.DEC.005 dhe ATM/ANS.EQMT.DEC.045 të aneksit III nuk zbatohen për EUSPA. EUSPA siguron që Agjencisë t'i jepet akses në prova nga entitete të ndryshme të përfshira në projektimin dhe prodhimin e pajisjeve ATM/ANS të sistemit EGNOS, me qëllim që të përcaktojë pajtueshmërinë e vazhdueshme me specifikimet teknike të zbatueshme në bazë të të cilave është bërë deklarata mbi pajisjet ATM/ANS në përputhje me aneksin III.

Neni 6

Konfirmim i përputhshmërisë

1. Pajisja e mëposhtme ATM/ANS do të lëshohet me një konfirmim të përputhshmërisë:

a) pajisje që nuk i nënshtrohet certifikimit në përputhje me nenin 4 dhe as deklaratës së përputhshmërisë në përputhje me nenin 5; dhe

b) që mbështet shërbimet e trafikut ajror, shërbimet e komunikimit, navigimit ose mbikëqyrjes, menaxhimit të hapësirës ajrore, menaxhimit të fluksit të trafikut ajror, shërbimet e informacionit aeronautik ose shërbimet meteorologjike.

Konfirmimi i përputhshmërisë konfirmon që pajisja ATM/ANS përputhet me specifikimet e detajuara të nxjerra nga Agjencia siç përshkruhet në nenin 76, pika 3 të VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil ", i ndryshuar.

2. Një konfirmim përputhshmërie për pajisjet ATM/ANS do të lëshohet nga ofruesi i ATM/ANS që integron pajisje të tilla ATM/ANS në sistemin e tij funksional ose, me kërkesë të ofruesit të ATM/ANS, nga një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve të tilla ATM/ANS të miratuar në përputhje me rregulloren mbi përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin ose prodhimin e sistemeve dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të navigimit ajror, sipas shtojcës II bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren (BE) 2023/1769.

3. Një konfirmim i përputhshmërisë për pajisjet ATM/ANS do të lëshohet për një kohëzgjatje të pakufizuar. Ai do të mbetet i vlefshëm nëse nuk zbatohet ndonjë nga sa vijon:

a) pajisja ATM/ANS nuk përputhet më me kërkesat thelbësore të përcaktuara në aneksin VIII dhe, nëse është e aplikueshme, në aneksin VII të VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar;

b) ofruesi i ATM/ANS nuk është më në përputhje me kërkesat e zbatueshme të urdhrit të ministrit nr. 193, datë 6.10.2022, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të

rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre", i ndryshuar, ose ka dorëzuar certifikatën e lëshuar në përputhje me nenin 6, të urdhrit të ministrit nr. 193, datë 6.10.2022, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre", i ndryshuar, ose certifikata është pezulluar ose revokuar;

c) ofruesi i ATM/ANS ka tërhequr deklaratën e pajtueshmërisë ose janë marrë masat e zbatimit në përputhje me pikën ATM/ANS.AR.C.050(e) të aneksit II të urdhrit të ministrit nr. 193, datë 6.10.2022 "Për miratimin e rregullores 'Për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre'", i ndryshuar.

Në këtë rast, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të njoftohet nga Ofruesi i Shërbimeve të Lundrimit Ajror, i cili është certifikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

Neni 7

Dispozitat kalimtare

1. Dispozitat e mëposhtme kalimtare do të zbatohen për pajisjet ATM/ANS që mbajnë deklarata KE të lëshuara në përputhje me nenet 5 ose 6 të udhëzimin nr. 8, datë 3.6.2010, "Për ndërveprimin në rrjetin evropian të menaxhimit të trafikut ajror", i ndryshuar, që përafron rregulloren nr. 552/2004 dhe që janë vendosur në funksionim përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje:

a) Pajisjet ATM/ANS që bëjnë pjesë në kategorinë e pajisjeve ATM/ANS që kërkojnë certifikim në përputhje me nenin 4 do të konsiderohen se janë lëshuar me një certifikatë sipas nenit 4, përveç nëse Autoriteti Kompetent i përshkruar në Nenin 3 të kësaj rregulloreje, e përcakton, pas vlerësimit të përmendur në paragrafin 2, që një pajisje e tillë ATM/ANS nuk siguron një nivel sigurie, mbrojtjeje, performance dhe ndërveprimi të barabartë me atë të kërkuar nga VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar dhe me këtë rregullore;

b) Pajisjet ATM/ANS që i përkasin kategorisë së pajisjeve ATM/ANS që kërkohet të deklarohen në përputhje me nenin 5, do të konsiderohen të jenë lëshuar me një deklaratë të përputhshmërisë së projektimit në përputhje me nenin 5, përveç nëse Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje përcakton, në vijim të vlerësimit të përmendur në paragrafin 2, që një pajisje e tillë ATM/ANS nuk siguron një nivel sigurie, mbrojtjeje, performance dhe ndërveprueshmërie të barabartë me atë të kërkuar nga VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar dhe kjo rregullore;

c) në lidhje me pajisjet ATM/ANS që i nënshtrohen një konfirmimi të përputhshmërisë në përputhje me nenin 6, deklaratat e KE-së për verifikimin e sistemeve që janë lëshuar ose njohur në përputhje me nenin 6 të udhëzimit nr. 8, datë 3.6.2010 "Për ndërveprimin në rrjetin evropian të menaxhimit të trafikut ajror", i ndryshuar, që përafron rregulloren nr. 552/2004, do të vazhdojnë të jenë të vlefshme për një kohëzgjatje të pakufizuar dhe do të konsiderohen se kanë një konfirmim të përputhshmërisë në përputhje me nenin 6.

2. Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje, vlerëson pajisjet ATM/ANS të përmendura në paragrafin 1, shkronjat "a" dhe "b", brenda 5 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje dhe publikon rezultatet e këtij vlerësimi. Për këtë qëllim, AAC-ja si përgjegjëse për certifikimin dhe mbikëqyrjen e ofruesve të ATM/ANS të përmendur në nenin 4, pika 1 të urdhrit të ministrit nr. 193, datë 6.10.2022 "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre", i ndryshuar, kur kërkohet, do t'i ofrojë Agjencisë informacionin përkatës për të lehtësuar këtë vlerësim. Objektivi i këtij vlerësimi do të jetë të përcaktojë nëse pajisjet përkatëse ATM/ANS garantojnë një nivel sigurie, mbrojtjeje, performance dhe ndërveprueshmërie të barabartë me atë të kërkuar nga VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, dhe kjo rregullore. Rezultati i vlerësimit do të publikohet dhe çdo masë për ndryshimin e pajisjes ATM/ANS të identifikuar nga vlerësimi, do të zbatohet pas 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, pavarësisht nga data aktuale kur bëhet vlerësimi, përveç nëse vlerësimi zbulon një mangësi që mund të ketë një efekt të dëmshëm në siguri. Në rast se zbulohet një mangësi që mund të ketë një efekt të dëmshëm, çdo masë për ndryshimin e pajisjes ATM/ANS të zbuluar nga vlerësimi do të zbatohet menjëherë. Pas 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi e

kësaj rregulloreje, pajisja ATM/ANS e përmendur në paragrafin 1, shkronjat "a" deri "b" do të konsiderohet se është në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

3. Pajisjet ATM/ANS që i nënshtrohen certifikimit në përputhje me nenin 4 ose një deklarate në përputhje me nenin 5, mund të vihen në funksion nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje deri më 12 shtator 2028 në bazë të një konfirmimi të përputhshmërisë të bërë në përputhje me nenin 6. Që nga 13 shtatori 2028, dispozitat e mëposhtme do të zbatohen për këto pajisje ATM/ANS:

a) Pajisjet ATM/ANS që bëjnë pjesë në kategorinë e pajisjeve ATM/ANS që kërkojnë certifikim në përputhje me nenin 4 dhe për të cilat është lëshuar një konfirmim i përputhshmërisë nga ofruesi i ATM/ANS do të konsiderohen se janë lëshuar me një certifikatë në përputhje me nenin 4 përveç rasteve kur Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje përcakton, pas vlerësimit të përmendur në paragrafin 4, se një pajisje e tillë ATM/ANS nuk siguron një nivel sigurie, mbrojtjeje, performancë dhe ndërveprimi të barabartë me atë të kërkuar nga VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil ", i ndryshuar dhe kjo rregullore;

b) Pajisjet ATM/ANS që bëjnë pjesë në kategorinë e pajisjeve ATM/ANS që kërkojnë një deklaratë të përputhshmërisë së projektimit në përputhje me nenin 5 dhe për të cilat është lëshuar një konfirmim i përputhshmërisë nga ofruesi i ATM/ANS do të konsiderohen se janë lëshuar me deklaratën e përputhshmërisë së projektimit në përputhje me nenin 5, përveç rastit kur Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje përcakton, pas vlerësimit të përmendur në paragrafin 4, se një pajisje e tillë ATM/ANS nuk garanton një nivel sigurie, mbrojtjeje, performance dhe ndërveprueshmërie të barabartë me atë të kërkuar nga VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, dhe kjo rregullore.

4. Agjencia vlerëson pajisjet ATM/ANS të përmendura në paragrafin 3 jo më vonë se 12 shtatori 2030. Për këtë qëllim, AAC-ja, si autoriteti kompetent përgjegjës për certifikimin dhe mbikëqyrjen e ofruesve të ATM/ANS të përmendura në nenin 4, pika 1, të urdhrit të ministrit nr. 193, datë 6.10.2022, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre", i ndryshuar do t'i ofrojnë Agjencisë informacionin përkatës për të lehtësuar këtë vlerësim. Objektivi i këtij vlerësimi do të jetë të përcaktojë nëse pajisja e veçantë ATM/ANS përmbush një nivel sigurie, mbrojtjeje, performance dhe ndërveprueshmërie të barabartë me atë të kërkuar nga VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil ", i ndryshuar, dhe kjo rregullore.

ANEKSI I
KËRKESAT PËR AUTORITETIN KOMPETENT
(Pjesa-ATM/ANS.EQMT.AR)

NËNPJESA A

KËRKESAT E PËRGJITHSHME (ATM/ANS.EQMT.AR.A)

ATM/ANS.EQMT.AR.A.001 Fushëveprimi

Ky aneks përcakton kërkesat për që zbatohen nga Autoriteti Komptent në lidhje me kushtet për kryerjen e certifikimit, dhe aktiviteteve të tjera të nevojshme për të siguruar mbikëqyrje efektive të pajisjeve ATM/ANS. Këto parashikime synojnë të informojnë përdoruesit mbi procedurat dhe rregullat që ndjek Agjencia për certifikimet dhe pranimet e deklarimeve sipas legjislacionit evropian.

ATM/ANS.EQMT.AR.A.030 Direktivat e pajisjeve ATM/ANS

a) Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje lëshon një direktivë për pajisjet ATM/ANS kur:

1. ajo ka përcaktuar se në pajisje ekziston një gjendje rrezikshmërie, pasigurie, pamjaftueshmërie ose pandërveprueshmërie si rezultat i një mangësie në pajisje; dhe

2. kjo gjendje ka të ngjarë të ekzistojë ose zhvillohet në pajisje të tjera ATM/ANS.

b) Një direktivë për pajisjet ATM/ANS përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

1. identifikimin e kushteve të pasigurta, të funksionimit të pamjaftueshëm ose të mosndërveprimit;

2. pajisjet e prekura/përfshira ATM/ANS;

3. veprimet e kërkuara dhe arsyetimi;

4. kohën e realizimit për veprimet e kërkuara;

5. datën e hyrjes në fuqi.

Autoriteti i Aviacionit Civil pranon dhe publikon direktivat e nxjerra nga Agjencia.

ATM/ANS.EQMT.AR.A.035 Specifikimet e detajuara për pajtueshmërinë e projektimit të pajisjeve

a) Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje vendos dhe vë në dispozicion specifikime të detajuara që organizatat mund të përdorin për të demonstruar pajtueshmërinë me kërkesat thelbësore përkatëse të përcaktuara në aneksin VIII dhe, nëse është e aplikueshme, aneksin VII të VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil "i ndryshuar, që përafron rregulloren (BE) 2018/1139 kur ato:

1. aplikojnë për certifikimin e pajisjeve ATM/ANS siç përshkruhet edhe në nenin 4;

2. deklarojnë përputhshmërinë e projektimit të pajisjeve ATM/ANS siç përshkruhet edhe nenin 5;

3. bëjnë një konfirmim të përputhshmërisë siç përshkruhet edhe në nenin 6.

b) Specifikimet e detajuara të përmendura në shkronjën "a" do të tregojnë standardet e projektimit që pasqyrojnë gjendjen e teknologjisë dhe praktikat më të mira të projektimit, dhe që bazohen në përvojën e vlefshme të fituar dhe përparimin shkencor dhe teknik, si dhe në provat dhe analizat më të mira të disponueshme në lidhje me pajisjet ATM/ANS.

Autoriteti i Aviacionit Civil pranon dhe publikon specifikimet e nxjerra nga Agjencia.

NËNPJESA B

CERTIFIKIMI, MBIKËQYRJA DHE ZBATIMI (ATM/ANS.EQMT.AR.B)

ATM/ANS.EQMT.AR.B.001 ATM/ANS Baza e certifikimit të pajisjeve

a) Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje do të krijojë bazën e certifikimit të pajisjeve ATM/ANS dhe do ta njoftojë atë tek aplikanti për një certifikatë të pajisjes ATM/ANS. Baza e certifikimit do të përbëhet nga sa vijon:

1. specifikimet e detajuara të certifikimit të lëshuara nga Autoriteti Kompetent siç përshkruhet në pikën ATM/ANS.EQMT.AR.A.035, që janë të zbatueshme për pajisjet ATM/ANS në datën e paraqitjes së aplikimit për atë certifikatë, ose ato përkatëse të lëshuara nga Agjencia dhe të pranuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil, përveç nëse:

i) aplikanti zgjedh të pajtohet, ose kërkohet të pajtohet në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.CERT.015(e), me specifikimet e detajuara të certifikimit që u bënë të zbatueshme pas datës së paraqitjes së aplikimit, rast në të cilin Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje do të përfshijë në bazën e certifikimit të pajisjeve ATM/ANS çdo specifikim tjetër certifikimi që lidhet drejtpërdrejt; ose

ii) Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje pranon çdo alternativë ndaj një specifikimi të detajuar të certifikimit të përcaktuar që nuk mund të përmbushet, për të cilin janë gjetur faktorë kompensues që ofrojnë një nivel ekuivalent sigurie ose për të siguruar ekuivalencë me specifikimet e aplikueshme të certifikimit; dhe

2. çdo kusht të veçantë të përcaktuar nga Autoriteti Kompetent siç përshkruhet në pikën ATM/ANS.EQMT.AR.B.005.

b) Përfshirja e mundshme e veçorive, karakteristikave ose funksioneve shtesë që nuk janë përfshirë fillimisht në bazën e certifikimit do të miratohet nga Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje.

ATM/ANS.EQMT.AR.B.005 Kushtet e veçanta

a) Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje do të vendosë kërkesa shtesë, të quajtura 'kushte të veçanta', për pajisjet ATM/ANS nëse specifikimet përkatëse të detajuara të zbatueshme nuk konsiderohen të përshtatshme për shkak të njërës nga sa vijon:

1. pajisja ATM/ANS ka karakteristika të reja ose të pazakonta të projektimit në lidhje me praktikat e projektimit në të cilat bazohen specifikimet e detajuara të zbatueshme;

2. përdorimi i synuar i pajisjes ATM/ANS është jokonvencional;

3. përvoja me pajisje të tjera të ngjashme ATM/ANS në shërbim që kanë karakteristika të ngjashme të projektimit ose rreziqe të identifikuara rishtazi ka treguar se mund të zhvillohen kushte të padëshiruara;

4. mjedisi në vendin e instalimit pengon fizikisht përmbushjen e kërkesave të caktuara të specifikimeve të detajuara të zbatueshme.

b) Kushtet e veçanta përmbajnë standarde të sigurisë, performancës, mbrojtjes dhe ndërveprueshmërisë që Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje i sheh të nevojshme për të siguruar që niveli i duhur i performancës së pajisjeve ATM/ANS është i barabartë me atë të kërkuar nga specifikimet e detajuara të zbatueshme.

ATM/ANS.EQMT.AR.B.010 Niveli i përfshirjes

a) Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje do të përcaktojë nivelin e saj të përfshirjes në verifikimin e aktiviteteve të demonstrimit të përputhshmërisë dhe të dhënave në lidhje me një aplikim për lëshimin e një certifikate ose për ndryshime në të. Ai do ta përcaktojë këtë bazuar në vlerësimin e grupeve subjektive të aktiviteteve të demonstrimit të përputhshmërisë dhe të dhënave nga programi i certifikimit.

Vlerësimi do të adresojë të gjitha sa vijon:

1. gjasat e një mospërputhjeje të paidentifikuar me bazën e certifikimit;

2. ndikimin e mundshëm të kësaj mospërputhjeje në sigurinë, mbrojtjen, specifikimet e shërbimit dhe funksionimin e pajisjeve ATM/ANS.

Ai do të marrë parasysh të paktën elementët e mëposhtëm:

i) tiparet e reja ose të pazakonta të projektit të certifikimit, duke përfshirë aspektet operacionale, organizative dhe të menaxhimit të njohurive;

ii) kompleksitetin e projektimit dhe/ose demonstrimit të përputhshmërisë;

iii) aspektet kritike të projektimit ose teknologjisë, rreziqet e lidhura me sigurinë ose pajtueshmërinë me shërbimin dhe funksionimin e pajisjeve ATM/ANS, duke përfshirë ato të identifikuara në projektime të ngjashme;

iv) performancën dhe përvojën e aplikantit në fushën në fjalë.

b) Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje njofton aplikantin për nivelin e tij të përfshirjes dhe përditëson nivelin e tij të përfshirjes kur kjo garantohet nga informacioni që ka një ndikim të dukshëm në rrezikun e vlerësuar më parë në përputhje me shkronjën "a". Autoriteti Kompetent njofton aplikuesin për çdo ndryshim në nivelin e përfshirjes.

ATM/ANS.EQMT.AR.B.015 Lëshimi i një certifikate të pajisjes ATM/ANS

a) Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje do të lëshojë një certifikatë për pajisjet ATM/ANS me kusht që:

1. Aplikanti ka demonstruar përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.CERT.015;

2. Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje nuk ka identifikuar ndonjë mospërputhje me bazën e certifikimit të pajisjeve ATM/ANS nëpërmjet verifikimit të aktiviteteve të demonstrimit të përputhshmërisë të përcaktuara në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.AR.B.010;

3. nuk është identifikuar asnjë veçori ose karakteristikë që mund ta bëjë pajisjen të pasigurt për përdorimin e synuar.

b) Certifikata e pajisjes ATM/ANS do të përfshijë kufizimet e funksionimit, skedën teknike të të dhënave për përshtatshmërinë e vazhdueshme, bazën e aplikueshme të certifikimit të pajisjes ATM/ANS me të cilën Autoriteti i Aviacionit Civil regjistron pajtueshmërinë, dhe çdo kusht ose kufizim tjetër të përshkruar në specifikimet e detajuara dhe kushtet e veçanta të zbatueshme.

ATM/ANS.EQMT.AR.B.020 Hetimi fillestar i mbikëqyrjes së deklaratës së përputhshmërisë së projektimit të pajisjeve ATM/ANS

a) Pas marrjes së një deklarate për pajtueshmërinë e projektimit të pajisjeve ATM/ANS nga një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS dhe të miratuar nga Autoriteti Kompetent në përputhje me rregulloren mbi përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin ose prodhimin e sistemeve dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të navigimit ajror, sipas shtojcës II bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren (BE) 2023/1769, Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje do të verifikojë që respektohet sa më poshtë:

1. Deklaruesi ka privilegjin të deklarojë përputhshmërinë e projektimit në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.DEC.005;

2. Deklarata përmban të gjithë informacionin e renditur në pikën ATM/ANS.EQMT.DEC.010;

3. Deklarata nuk përmban informacion që tregon një mospërputhje me kërkesat e zbatueshme të aneksit III dhe nuk është identifikuar asnjë veçori ose karakteristikë që mund ta bëjë pajisjen ATM/ANS të pasigurt për përdorimin e synuar.

b) Deklarata e përputhshmërisë së projektimit të pajisjes ATM/ANS do të përfshijë kufizimet e funksionimit, skedën teknike të të dhënave për përshtatshmërinë e vazhdueshme, specifikimet e detajuara të zbatueshme me të cilat organizata ka demonstruar pajtueshmërinë, dhe çdo kusht ose kufizim tjetër të përcaktuar në specifikimet e detajuara të zbatueshme dhe kushtet e veçanta.

c) Nëse deklarata nuk është në përputhje me privilegjet e organizatës ose përmban informacion që tregon mospërputhje me specifikimet e detajuara të zbatueshme dhe kushtet e veçanta, Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje do të njoftojë organizatën në fjalë për

mospërputhshmërinë dhe do të kërkojë informacione të mëtejshme, veprime korrigjuese dhe prova për këtë.

d) Nëse plotësohen kërkesat në shkronjat "a" dhe "b", Autoriteti Kompetent do të konfirmojë marrjen e deklaratës.

ATM/ANS.EQMT.AR.B.025 Regjistrimi i një deklarate të përputhshmërisë së projektimit të pajisjeve ATM/ANS

Autoriteti Kompetent regjistron një deklaratë të përputhshmërisë së projektimit të pajisjeve ATM/ANS në një bazë të dhënash të përshtatshme, me kusht që:

a) deklaruesi ka deklaruar përputhshmërinë e projektimit të pajisjes ATM/ANS në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.DEC.010;

b) deklaruesi është zotuar të marrë përsipër detyrimet e përcaktuara në aneksin III;

c) nuk ka probleme të pazgjidhura në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.AR.B.020.

ATM/ANS.EQMT.AR.B.030 Ndryshimet në deklarata

a) Me marrjen e njoftimit për ndryshimet në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.DEC.020, Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje verifikon plotësinë e njoftimit në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.AR.B.020.

b) Kur ndryshimi/ndryshimet prekin (ndikojnë) çdo aspekt të deklaratës që është regjistruar në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.AR.B.025, Autoriteti i Aviacionit Civil përditëson regjistrin.

c) Pas përfundimit të aktiviteteve të kërkuara nga shkronjat "a" dhe "b", Autoriteti i Aviacionit Civil do të pranojë marrjen e njoftimit për organizatën e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS.

ANEKSI II
CERTIFIKATA PAJISJEVE ATM/ANS
(Pjesa-ATM/ANS.EQMT.CERT)

ATM/ANS.EQMT.CERT.001 Fushëveprimi

Ky aneks përcakton procedurat për lëshimin e certifikatave për pajisjet ATM/ANS në përputhje me nenin 4, si dhe të drejtat dhe detyrimet e aplikantit dhe mbajtësit të këtyre certifikatave.

ATM/ANS.EQMT.CERT.005 Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik që ka demonstruar, ose është në proces demonstrimi, aftësitë e tyre të projektimit në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.CERT.010, mund të aplikojë për lëshimin e një certifikate të pajisjes ATM/ANS sipas kushteve të përcaktuara në këtë aneks.

ATM/ANS.EQMT.CERT.010 Demonstrimi i aftësisë

Një aplikant për një certifikatë të pajisjes ATM/ANS duhet të ketë një miratim të organizatës së projektimit të lëshuar nga Autoriteti Kompetent në përputhje me rregulloren mbi përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin ose prodhimin e sistemeve dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të navigimit ajror, sipas shtojcës II bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren (BE) 2023/1769, që mbulon pajisjet përkatëse ATM/ANS.

ATM/ANS.EQMT.CERT.015 Aplikimi për një certifikatë të pajisjes ATM/ANS

a) Aplikimi për certifikatë të pajisjes ATM/ANS, ose për ndryshime në të, bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje.

b) Një aplikim për një certifikatë të pajisjes ATM/ANS duhet të përfshijë, minimalisht:

1. të dhënat përshkruese paraprake të pajisjes ATM/ANS dhe përdorimin e saj të synuar;

2. një program certifikimi për demonstrimin e pajtueshmërisë në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.CERT.025, i përbërë nga sa vijon:

i) një përshkrim të detajuar të projektimit, duke përfshirë të gjitha konfigurimet që do të certifikohen;

ii) karakteristikat dhe kufizimet e pajisjeve të propozuara;

iii) përdorimin e synuar të pajisjes ATM/ANS;

iv) një propozim për bazën fillestare të certifikimit, duke përfshirë specifikimet e detajuara të certifikimit të zbatueshëm, kushtet e veçanta të propozuara, gjetjet e propozuara ekuivalente të sigurisë, si dhe një mjet të propozuar përputhshmërie dhe devijimet e propozuara, sipas rastit, të përgatitur në përputhje me kërkesat dhe opsionet e përcaktuara në pikën ATM/ANS.EQMT.AR.B.001;

v) një propozim për ndarjen e programit të certifikimit në grupe subjektive të aktiviteteve dhe të dhënave të demonstrimit të përputhshmërisë, duke përfshirë një propozim për mjetet e pajtueshmërisë dhe dokumentet përkatëse të demonstrimit të përputhshmërisë;

vi) një propozim për vlerësimin e grupeve subjektive të aktiviteteve dhe të dhënave të demonstrimit të përputhshmërisë, duke trajtuar mundësinë e një mospërputhjeje të paidentifikuar me kërkesat e bazës së certifikimit dhe ndikimin e mundshëm të kësaj mospërputhjeje në pajisjet ATM/ANS; vlerësimi i propozuar do të marrë parasysh të paktën elementet e përcaktuara në pikat (a)(2)(i) deri në (iv) të pikës ATM/ANS.EQMT.AR.B.010; në bazë të këtij vlerësimi, aplikimi do të përfshijë një propozim për nivelin e përfshirjes së Autoritetit Kompetent në verifikimin e aktiviteteve dhe të dhënave të demonstrimit të përputhshmërisë;

vii) një plan projekti duke përfshirë fazat kryesore.

c) Pas paraqitjes fillestare të aplikimit në Autoritetin Kompetent të përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje, aplikanti do të përditësojë programin e certifikimit kur ka ndryshime në projektin e certifikimit që prekin ndonjë nga shkronja (b)(2)(i) deri në (vii).

d) Një aplikim për lëshimin e një certifikate të pajisjes ATM/ANS do të jetë i vlefshëm për 5 vjet, përveç nëse aplikanti demonstron në kohën e aplikimit se kërkon një periudhë më të gjatë kohore për të demonstruar pajtueshmërinë dhe Autoriteti Kompetent pranon ta zgjasë atë periudhë kohore.

e) Në rastin kur një certifikatë e pajisjes ATM/ANS nuk është lëshuar, ose është e qartë se ajo nuk do të lëshohet, brenda afatit kohor të parashikuar në shkronjën "d", aplikanti mund:

1. të paraqesë një aplikim të ri dhe të përmbushë kërkesat për bazën e certifikimit, siç përcaktohet dhe njoftohet nga Autoriteti Kompetent në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.AR.B.001 për datën e paraqitjes së aplikimit të ri; ose

2. të aplikojë për një zgjatje të afatit kohor të parashikuar në shkronjën "d" dhe të propozojë një datë të re për lëshimin e certifikatës; në atë rast, aplikanti duhet të përmbushë kërkesat për bazën e certifikimit, siç përcaktohet dhe njoftohet nga Autoriteti Kompetent në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.AR.B.001 për një datë që do të zgjidhet nga aplikanti; megjithatë, kjo datë nuk do t'i paraprijë datës së re të propozuar nga aplikanti për lëshimin e certifikatës për më shumë se 5 vjet për një aplikim për lëshimin e një certifikate të pajisjes ATM/ANS.

ATM/ANS.EQMT.CERT.020 Ndryshimet që kërkojnë lëshimin e një certifikate të re të pajisjes ATM/ANS

Një organizatë projektuese e miratuar që propozon ndryshime në pajisjet ATM/ANS do të aplikojë për lëshimin e një certifikate të re kur ndryshimet në projektimin ose funksionalitetin e asaj pajisjeje ATM/ANS janë aq të gjera sa nevojitet një hetim i plotë i përputhshmërisë me bazën e aplikueshme të certifikimit.

ATM/ANS.EQMT.CERT.025 Demonstrimi i pajtueshmërisë me bazën e certifikimit të pajisjeve ATM/ANS.

a) Një aplikant, pas pranimit të programit të certifikimit nga Autoriteti Kompetent i përshkruar në Nenin 3 të kësaj rregulloreje, duhet të demonstrojë pajtueshmërinë me bazën e certifikimit të pajisjeve ATM/ANS siç i është përcaktuar dhe njoftuar aplikantit nga Autoriteti Kompetent në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.AR.B.001 dhe do t'i ofrojë Autoritetit Kompetent mjetet me të cilat është demonstruar një përputhshmëri e tillë.

b) Një aplikant për një certifikatë të pajisjeve ATM/ANS duhet të përditësojë programin e certifikimit me bazën e përditësuar të certifikimit në rast se Autoriteti Kompetent identifikon nevojën që aplikanti ta bëjë këtë pas paraqitjes fillestare të vendosur në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.CERT.015.

c) Aplikanti duhet t'i raportojë Autoritetit Kompetent të përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje, çdo vështirësi ose ngjarje të hasur gjatë procesit të demonstrimit të përputhshmërisë që mund të ketë një efekt të dukshëm në vlerësimin sipas pikës ATM/ANS.EQMT.CERT.015(b)(2)(vi) ose në programin e certifikimit ose përndryshe mund të kërkojë një ndryshim në nivelin e përfshirjes së Autoritetit Kompetent të njoftuar më parë tek aplikanti në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.AR.B.010(b).

d) Një aplikant duhet të regjistrojë demonstrimet e përputhshmërisë brenda dokumenteve të përputhshmërisë siç përmendet në programin e certifikimit.

e) Pas përfundimit të të gjitha aktiviteteve të demonstrimit të përputhshmërisë në përputhje me programin e certifikimit, duke përfshirë çdo inspektim dhe test të kryer në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.CERT.040, një aplikant duhet të deklarojë dhe dorëzojë në një formë dhe mënyrë të përcaktuar nga Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje, që:

1. ka demonstruar pajtueshmëri me bazën e certifikimit, siç përcaktohet dhe njoftohet nga AAC-ja, në vijim të programit të certifikimit të pranuar nga Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje në përputhje me shkronjën "a";

2. nuk është identifikuar asnjë veçori ose karakteristikë që mund ta bëjë pajisjen ATM/ANS të papërshtatshme për përdorimin e synuar.

f) Aplikanti duhet të demonstrojë se veçoritë, karakteristikat ose funksionet që nuk janë pjesë e bazës së certifikimit nuk kanë asnjë ndërhyrje ose efekt të dëmshëm në përshtatshmërinë e pajisjes ATM/ANS për përdorimin e synuar.

ATM/ANS.EQMT.CERT.030 Mjetet e përputhshmërisë

a) Agjencia zhvillon mjete të pranueshme përputhshmërie ("AMC") që mund të përdoren për të përcaktuar pajtueshmërinë me VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar dhe aktet në zbatim të tij. Autoriteti i Aviacionit Civil pranon dhe publikon mjetet e pranueshme të përputhshmërisë të zhvilluara dhe nxjerra nga Agjencia.

b) Mjetet alternative të përputhshmërisë mund të përdoren për të përcaktuar pajtueshmërinë me këtë rregullore.

ATM/ANS.EQMT.CERT.035 Projektimi i pajisjeve ATM/ANS

a) Projektimi i pajisjeve ATM/ANS përbëhet nga:

1. vizatimet/skicat dhe specifikimet, si dhe një listë e atyre skicave dhe specifikimeve, të nevojshme për të përcaktuar konfigurimin dhe veçoritë e projektimit të treguara në përputhje me bazën e certifikimit;

2. informacioni mbi proceset dhe metodat e prodhimit dhe montimit të pajisjeve të nevojshme për të siguruar konformitetin e pajisjeve ATM/ANS;

3. një seksion kufizimesh të miratuara të udhëzimeve për përshtatshmërinë e vazhdueshme siç përcaktohet nga specifikimet e detajuara të certifikimit të zbatueshëm;

4. çdo të dhënë tjetër që lejon me anë të krahasimit përcaktimin e përshtatshmërisë së projektimit.

b) Çdo projektim duhet të identifikohet në mënyrë të përshtatshme.

ATM/ANS.EQMT.CERT.040 Inspektimi dhe testimi

a) Përpara se çdo test të ndërmerret gjatë demonstrimit të përputhshmërisë së kërkuar nga pika ATM/ANS.EQMT.CERT.025, aplikanti duhet të ketë verifikuar:

1. për mostrën e provës, që:

i) pjesët standarde, elementet, konfigurimi, kodimi dhe proceset janë në përputhje me specifikimet për projektimin e propozuar;

ii) pajisja e zhvilluar ATM/ANS është në përputhje me projektimin e propozuar;

iii) proceset e prodhimit, ndërtimi dhe montimi janë në përputhje në mënyrë të përshtatshme me ato të specifikuara në projektin e propozuar të pajisjes; dhe

2. për provën dhe pajisjet matëse që do të përdoren për provë/test, që ato të jenë të përshtatshme për testimin dhe të kalibruar siç duhet.

b) Në bazë të verifikimeve të kryera në përputhje me shkronjën "a", aplikanti do të lëshojë një deklaratë verifikimi që liston çdo mospërputhje të mundshme, së bashku me një justifikim se kjo nuk do të ndikojë në rezultatet e testit dhe do të lejojë Autoritetin Kompetent të kryejë çdo inspektim që e konsideron të nevojshëm për të kontrolluar vlefshmërinë e asaj deklarate.

c) Aplikanti do të lejojë Autoritetin Kompetent, që:

1. të shqyrtojë çdo të dhënë dhe informacion në lidhje me demonstrimin e pajtueshmërisë;

2. të dëshmojë ose kryejë çdo lloj testi ose inspektimi me qëllim të demonstrimit të pajtueshmërisë.

d) Për të gjitha testet dhe inspektimet e realizuara nga Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje:

1. aplikanti i paraqet Autoritetit Kompetent një deklaratë verifikimi në përputhje me shkronjën "b";

2. asnjë ndryshim që ndikon në vlefshmërinë e deklaratës së verifikimit nuk do t'i bëhet kampionit/mostrës së provës, ose pajisjes së provës dhe matjes, ndërmjet kohës së lëshimit të deklaratës së verifikimit të parashikuar në shkronjën "b" dhe kohës së paraqitjes së kampionit të provës ose të dëshmuar nga Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje për testim.

ATM/ANS.EQMT.CERT.045 Mbajtja e të dhënave

Përveç kërkesave për mbajtjen e të dhënave të përshtatshme ose të lidhura me sistemin e menaxhimit, të gjitha informacionet përkatëse të projektimit, vizatimet/skicat dhe raportet e testimit, duke përfshirë të dhënat e inspektimit dhe testet e regjistruara, do të vihen në dispozicion nga mbajtësi i certifikatës për Autoritetin Kompetent dhe do të ruhen për të siguruar informacionin e nevojshëm për të garantuar pajtueshmërinë e vazhdueshme.

ATM/ANS.EQMT.CERT.050 Manualet

Mbajtësi i një certifikate të pajisjes ATM/ANS duhet të prodhojë, mirëmbajë dhe përditësojë kopjet kryesore të të gjitha manualeve të kërkuara nga baza e certifikimit në fuqi, dhe t'i japë Autoritetit Kompetent kopje, sipas kërkesës.

ATM/ANS.EQMT.CERT.055 Udhëzimet e mirëmbajtjes

a) Mbajtësi i një certifikate të pajisjes ATM/ANS duhet t'u japë të gjithë përdoruesve të njohur të paktën një grup udhëzimesh të plota të mirëmbajtjes, që përmbajnë të dhëna përshkruese dhe udhëzime për realizimin, të përgatitur në përputhje me bazën e certifikimit në fuqi, dhe do t'i vërë ato në dispozicion sipas kërkesës për çdo person tjetër të cilit i kërkohet që të jetë në përputhje me ndonjë nga këto udhëzime të mirëmbajtjes.

b) Ndryshimet në udhëzimet e mirëmbajtjes do të vihen në dispozicion të të gjithë përdoruesve të njohur dhe do të vihen në dispozicion me kërkesë të çdo personi të cilit i kërkohet që të jetë në përputhje me ndonjë nga këto udhëzime të mirëmbajtjes. Një program që tregon se si ndryshimet në udhëzimet e mirëmbajtjes vihen në dispozicion për të gjithë përdoruesit e njohur do t'i dorëzohet Autoritetit Kompetent.

ATM/ANS.EQMT.CERT.060 Ndryshimet në bazën e certifikimit të pajisjeve ATM/ANS

a) Të gjitha ndryshimet do të miratohen nga Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje, pasi mbajtësi i certifikatës demonstron se ndryshimet dhe zonat e prekura nga ndryshimet përputhen me bazën e certifikimit të përcaktuar nga Autoriteti Kompetent siç përshkruhet në pikën ATM/ANS.EQMT.AR.B.001.

b) Me përjashtim të shkronjës "a", ndryshimet brenda fushëveprimit të privilegjeve të organizatës pas një procedure të miratuar të menaxhimit të ndryshimit do të menaxhohen nga organizata e miratuar e projektimit dhe do të kufizohen në konfigurimin(et) specifik të pajisjes ATM/ANS me të cilat lidhen ndryshimet.

c) Për këtë qëllim, mbajtësi i një certifikate të pajisjes ATM/ANS duhet të ketë një sistem për të identifikuar qëllimin e ndryshimeve në pajisjet ATM/ANS si "të vogla" dhe "të mëdha".

d) Ndryshimet do të lëshohen me një deklaratë në përputhje me shkronjën (b)(2) të pikës DPO.OR.C.001 të aneksit II (Pjesa-DPO.OR) të rregullores për përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin ose prodhimin e sistemeve dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të navigimit ajror, sipas shtojcës II bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren (BE) 2023/1769.

ATM/ANS.EQMT.CERT.065 Direktivat e pajisjeve ATM/ANS

Kur lëshohet një direktivë për pajisjet ATM/ANS për të korrigjuar gjendjen e përmendur në shkronjën "b" të ATM/ANS.EQMT.AR.A.030, mbajtësi i certifikatës së pajisjes ATM/ANS, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje në rast se nevojiten veprime urgjente, duhet:

a) të propozojë veprimet e duhura korrigjuese dhe t'ia dorëzojë Autoritetit Kompetent detajet e atij propozimi për miratim;

b) pas miratimit nga Autoriteti Kompetent, të vërë në dispozicion të gjithë përdoruesve të njohur të pajisjeve ATM/ANS dhe autoriteteve kompetente përkatëse, dhe nëse është e zbatueshme dhe sipas kërkesës, çdo personi të cilit i kërkohet që të pajtohet me direktivën për pajisjet ATM/ANS, të dhënat përshkruese të përshtatshme dhe udhëzimet e realizimit.

ATM/ANS.EQMT.CERT.070 Inspektimet e kryera nga Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje

Me kërkesë të Autoritetit Kompetent, çdo organizatë që zotëron një certifikatë të lëshuar nga Autoriteti Kompetent sipas këtij aneksi:

a) do t'i japë Autoritetit Kompetent akses në çdo objekt, pajisje, dokument, regjistrim, të dhëna, proces, procedurë ose ndonjë material tjetër, dhe të lejojë Autoritetin Kompetent të shqyrtojë çdo raport, të bëjë çdo inspektim dhe të kryejë ose të dëshmojë çdo test që është i nevojshëm për të verifikuar pajtueshmërinë e organizatës me kërkesat e zbatueshme të këtij aneksi;

b) nëse personi fizik ose juridik punëson partnerë, furnitorë ose nënkontraktorë, do të bëjë marrëveshje me ta për të siguruar që Autoriteti Kompetent të ketë akses tek ata dhe mund të hetojë siç përshkruhet në shkronjën "a".

ANEKSI III

DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË SË PROJEKTIMIT TË PAJISJEVE TË ATM/ANS

ATM/ANS.EQMT.DEC.001 Fushëveprimi

Ky aneks përcakton procedurat për deklarimin e përputhshmërisë së projektimit të pajisjes ATM/ANS dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e organizatave të përfshira në projektimin e pajisjeve ATM/ANS që janë të autorizuara të lëshojnë deklarata.

ATM/ANS.EQMT.DEC.005 Pranueshmëria dhe demonstrimi i pajtueshmërisë

Një organizatë e përfshirë në projektimin e pajisjeve ATM/ANS duhet të demonstrojë aftësinë e saj për të deklaruar përputhshmërinë e projektimit të pajisjeve të caktuara ATM/ANS duke mbajtur një miratim organizate të lëshuar nga Autoriteti Kompetent në përputhje me rregulloren mbi përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin ose prodhimin e sistemeve dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të navigimit ajror, sipas shtojcës II bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren (BE) 2023/1769, siç specifikohet në kushtet e miratimit të organizatës.

ATM/ANS.EQMT.DEC.010 Deklarata e përputhshmërisë së projektimit të pajisjeve ATM/ANS

Një organizatë e miratuar duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kompetent një deklaratë të datuar dhe të nënshkruar për pajtueshmërinë e projektimit të pajisjeve të caktuara ATM/ANS. Deklarata duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) përshkrimin e projektimit, duke përfshirë të gjitha konfigurimet;

b) performancën e vlerësuar të pajisjes, kur është e përshtatshme, drejtpërdrejtë ose duke iu referuar dokumenteve të tjera plotësuese;

c) një deklaratë përputhshmërie që vërteton se pajisja plotëson specifikimet e zbatueshme dhe një listë të specifikimeve të deklarimit dhe kushteve të veçanta, sipas rastit;

d) referencën për provat përkatëse mbështetëse, duke përfshirë raportet e testimit;

e) referencën në manualet e duhura të funksionimit, konfigurimit dhe mirëmbajtjes;

f) nivelet e pajtueshmërisë, ku nivele të ndryshme të përputhshmërisë lejohen nga specifikimet e deklaratës;

g) listën e devijimeve, sipas rastit.

ATM/ANS.EQMT.DEC.015 Mjetet e përputhshmërisë

a) Agjencia zhvillon mjete të pranueshme përputhshmërie ("AMC") që mund të përdoren për të përcaktuar pajtueshmërinë me VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil ", i ndryshuar, dhe aktet në zbatim të tij. Autoriteti i Aviacionit Civil do të zhvillojë mjete të pranueshme përputhshmërie ("AMC") që mund të përdoren për të përcaktuar pajtueshmërinë me VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil ", i ndryshuar, dhe aktet në zbatim të tij. Autoriteti i Aviacionit Civil mund të përdorë mjetet e pranueshme të përputhshmërisë të zhvilluara dhe nxjerra nga Agjencia.

b) Mjetet alternative të përputhshmërisë mund të përdoren për të përcaktuar pajtueshmërinë me këtë rregullore.

ATM/ANS.EQMT.DEC.020 Ndryshimet në deklaratën e projektimit të pajisjeve ATM/ANS

a) Një organizatë e miratuar e përfshirë në projektimin e pajisjeve ATM/ANS mund të bëjë ndryshime në projektim, që janë brenda fushës së privilegjeve të organizatës së miratuar. Në këtë rast, pajisja e ndryshuar do të mbajë numrin e saj origjinal të pjesës.

b) Çdo ndryshim në projektim që është brenda fushës së privilegjeve të organizatës së miratuar dhe që është mjaftueshëm i gjerë për të kërkuar një hetim të plotë në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.AR.B.020 për të përcaktuar përputhshmërinë e tij, do të kërkojë caktimin e një modeli të ri për pajisjen.

ATM/ANS.EQMT.DEC.025 Mbajtja e të dhënave

Përveç kërkesave për mbajtjen e të dhënave të përshtatshme ose të lidhura me sistemin e menaxhimit, të gjitha informacionet përkatëse të projektimit, vizatimet/skicat dhe raportet e testimit, duke përfshirë të dhënat e inspektimit për pajisjet e testuara, do t'i vihen në dispozicion Autoritetit Kompetent dhe do të ruhen për të ofruar informacionin e nevojshëm për të siguruar përshtatshmërinë e vazhdueshme të pajisjeve ATM/ANS.

ATM/ANS.EQMT.DEC.030 Manualet

Organizata e përfshirë në projektimin e pajisjeve ATM/ANS, e cila ka bërë deklaratën, duhet të prodhojë, mirëmbajë dhe përditësojë kopjet kryesore të të gjitha manualeve të identifikuara në deklaratë dhe t'i japë Autoritetit Kompetent kopje, sipas kërkesës.

ATM/ANS.EQMT.DEC.035 Udhëzimet e mirëmbajtjes

a) Organizata e projektimit e cila ka bërë deklaratën duhet t'u japë të gjithë përdoruesve të njohur të paktën një grup udhëzimesh të plota për mirëmbajtjen, që përmbajnë të dhëna përshkruese dhe udhëzime për realizimin të përgatitur në përputhje me specifikimet e zbatueshme për pajisjet ATM/ANS të mbuluara nga deklarata dhe do t'i vërë ato në dispozicion sipas kërkesës për çdo person tjetër të cilit i kërkohet që të jetë në përputhje me ndonjë nga kushtet e këtyre udhëzimeve të mirëmbajtjes.

b) Ndryshimet në udhëzimet e mirëmbajtjes do të vihen në dispozicion të të gjithë përdoruesve të njohur dhe do të vihen në dispozicion me kërkesë të çdo personi të cilit i kërkohet që të jetë në përputhje me ndonjë nga këto udhëzime të mirëmbajtjes. Një program që tregon se si ndryshimet në udhëzimet e mirëmbajtjes vihen në dispozicion për të gjithë përdoruesit e njohur, do t'i dorëzohet Autoritetit Kompetent sipas kërkesës.

ATM/ANS.EQMT.DEC.040 Direktivat e pajisjeve ATM/ANS

Kur lëshohet një direktivë për pajisjet ATM/ANS për të korrigjuar gjendjen e përmendur në shkronjën "b" të ATM/ANS.EQMT.AR.A.030, deklaruesi i përputhshmërisë së projektimit të pajisjes ATM/ANS, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje në rast se nevojiten veprime urgjente, duhet:

a) të propozojë veprimet e duhura korrigjuese dhe t'ia dorëzojë Autoritetit Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje detajet e atij propozimi për miratim;

b) pas miratimit nga Autoriteti Kompetent, të vërë në dispozicion të gjithë përdoruesve të njohur të pajisjeve dhe autoriteteve kompetente përkatëse, nëse është e zbatueshme, dhe, sipas kërkesës, çdo personi të cilit i kërkohet që të pajtohet me direktivën e pajisjeve ATM/ANS, të dhënat përshkruese të përshtatshme dhe udhëzimet e realizimit.

ATM/ANS.EQMT.DEC.045 Inspektimet e kryera nga Autoriteti Kompetent i përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje

Me kërkesë të Autoritetit Kompetent, çdo organizatë që është e autorizuar të lëshojë një deklaratë në përputhje me këtë rregullore:

a) do t'i japë Autoritetit Kompetent akses në çdo objekt, pajisje, dokument, regjistrim, të dhëna, proces, procedurë ose ndonjë material tjetër dhe të lejojë atë të shqyrtojë çdo raport, të bëjë çdo inspektim dhe të kryejë ose të dëshmojë çdo test që është i nevojshëm për të verifikuar pajtueshmërinë dhe pajtueshmërinë e vazhdueshme të organizatës me kërkesat e zbatueshme të këtij aneksi;

b) nëse personi fizik ose juridik përdor partnerë, furnitorë ose nënkontraktorë, do të bëjë marrëveshje me ta për të siguruar që Autoriteti Kompetent të ketë akses tek ata dhe mund të hetojë siç parashikohet në shkronjën "a".

SHTOJCA II

RREGULLORE

MBI PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE TEKNIKE DHE PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE PËR MIRATIMIN E ORGANIZATAVE TË PËRFSHIRA NË PROJEKTIMIN OSE PRODHIMIN E SISTEMEVE DHE PËRBËRËSVE TË MENAXHIMIT TË TRAFIKUT AJROR/SHËRBIMEVE TË LUNDRIMIT AJROR

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore përshkruan kërkesat teknike dhe procedurat administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin ose prodhimin e sistemeve ATM/ANS dhe përbërësve ATM/ANS që i nënshtrohen certifikimit, siç përshkruhet në nenin 4 të rregullores mbi përcaktimin e rregullave të detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror, sipas shtojcës I bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren 2023/1768 ose deklaratën e pajtueshmërisë së projektimit në përputhje me nenin 5 të asaj rregulloreje.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto përkufizime:

a) Agjencia nënkupton përbërësit e ATM/ANS siç përkufizohen në nenin 3(19) të VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar dhe sistemet ATM/ANS siç përkufizohen në nenin 3(23) të asaj VKM-je. Nuk përfshihen pajisjet në bord të avionit, të cilët janë subjekt i urdhrit të ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për kërkesat e aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit".

b) "Direktivë për pajisjet ATM/ANS", nënkupton një dokument i lëshuar nga Agjencia dhe pranuar dhe publikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, i cili përcakton veprimet që duhet të kryhen nga ofruesit e ATM/ANS në pajisjet ATM/ANS, për të adresuar një gjendje rrezikshmërie dhe/ose të pasigurt që është identifikuar dhe për të rivendosur performancën dhe ndërveprimin e asaj pajisjeje ATM/ANS, kur provat tregojnë se siguria, mbrojtja, performanca ose ndërveprimi i asaj pajisjeje të veçantë, mund të rrezikohet.

Neni 3
Kërkesat e autoritetit kompetent

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, autoriteti kompetent përgjegjës për lëshimin e miratimeve për organizatat e përfshira në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS dhe për mbikëqyrjen dhe zbatimin e rregullave kundrejt këtyre organizatave është, Agjencia.

2. Agjencia kur kryen certifikim, hetim, inspektim, auditim dhe aktivitete të tjera monitoruese të nevojshme për të siguruar mbikëqyrjen efektive të organizatave të përfshira në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS objekt i kësaj rregulloreje, zbaton kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian. Autoritetet kompetente kombëtare i sigurojnë Agjencisë mbështetje administrative për kryerjen e detyrave të saj në lidhje me certifikimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin gjatë ekzekutimit të funksioneve të saj.

Neni 4
Organizatat e përfshira në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS

1. Një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS që i nënshtrohen certifikimit, siç përshkruhet në nenin 4 të rregullores mbi përcaktimin e rregullave të detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror, sipas shtojcës I bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren 2023/1768 ose deklaratën e pajtueshmërisë së projektimit siç përshkruhet në nenin 5 të asaj rregulloreje, duhet të demonstrojë aftësinë e saj si një organizatë projektimi ose prodhimi për pajisjet ATM/ANS në përputhje me aneksin II bashkëlidhur rregullores, (Pjesa-DPO.OR).

2. Organizatat e përfshira në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS të Shërbimit Evropian të Mbulimit Gjeostacionar të Navigimit (EGNOS), do të konsiderohen se janë në përputhje me kërkesat e aneksit II të kësaj rregulloreje duke demonstruar përputhshmërinë e tyre me rregulloren (BE) 2021/696 dhe me standardet e menaxhimit, projektimit dhe cilësisë të zbatueshme për EGNOS sipas asaj rregulloreje. Këtyre organizatave nuk do t'u kërkohet që t'i nënshtrohen miratimit nga Agjencia.

Agjencia e Bashkimit Evropian për Programin Hapësinor siguron në rolin e saj të një organizate projektimi ose prodhimi që organizatat e tjera të përfshira në projektimin ose prodhimin e pajisjeve të EGNOS-it të ndjekin proceset e projektimit dhe prodhimit që rezultojnë në nivelin e sigurisë dhe ndërveprimit të barabartë me aneksin II (Pjesa-DPO.OR).

ANEKSI I
KËRKESAT PËR AUTORITETIN KOMPETENT TË PËRSHKRUAR NË NENIN 3 TË KËSAJ RREGULLOREJE
(Pjesa-DPO.AR)

NËNPJESA A KËRKESA TË PËRGJITHSHME (DPO.AR.A)

DPO.AR.A.001 Fushëveprimi

Ky aneks përshkruan kërkesat për sistemet e administrimit dhe menaxhimit për Agjencinë për detyrat e certifikimit, mbikëqyrjes dhe zbatimit të organizatave të projektimit ose prodhimit kur Agjencia ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e saj.

DPO.AR.A.010 Reagimi i menjëhershëm ndaj një problemi të sigurisë, mbrojtjes dhe ndërveprueshmërisë

a) Pa cenuar legjislacionin evropian për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil, dhe aktet e deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të tij, Agjencia zbaton një sistem për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e duhur të informacionit të sigurisë dhe ndërveprueshmërisë.

b) Pas marrjes së informacionit të përmendur në shkronjën "a", Agjencia merr masat e duhura për të adresuar çdo problem të identifikuar të sigurisë në operim, mbrojtjes ose ndërveprimit, duke përfshirë lëshimin e direktivave të pajisjeve ATM/ANS, siç përshkruhet në pikën ATM/ANS.EQMT.AR.A.030 të aneksit I të rregullores mbi përcaktimin e rregullave të detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror, sipas shtojcës I bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren 2023/1768.

c) Masat e marra sipas shkronjës "b" i njoftohen menjëherë organizatës përkatëse, e cila është e detyruar t'i zbatojë ato, në përputhje me pikën DPO.OR.A.035. Do të njoftohen gjithashtu autoritetet kompetente të ofruesve të ATM/ANS në fjalë. Ofruesi i ATM/ANS i certifikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil gjithashtu do të komunikojë me autoritetin për çdo masë të marrë ndaj organizatës përkatëse.

DPO.AR.A.015 Reagimi i menjëhershëm ndaj një incidenti ose cenueshmërie të sigurisë së informacionit me ndikim në sigurinë e aviacionit

a) Agjencia zbaton një sistem për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e duhur të informacionit në lidhje me incidentet dhe cenueshmëritë e sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim që raportohen nga organizatat. Kjo bëhet në koordinim me çdo autoritet tjetër përkatës përgjegjës për sigurinë e informacionit ose sigurinë kibernetike të Bashkimit Evropian për të rritur koordinimin dhe përputhshmërinë e skemave të raportimit.

b) Me marrjen e informacionit të përmendur në shkronjën "a", Agjencia merr masat e duhura për të adresuar ndikimin e mundshëm në sigurinë në operim të incidentit ose cenueshmërisë së sigurisë së informacionit.

c) Masat e marra në përputhje me shkronjën "b" do t'u njoftohen menjëherë të gjithë personave ose organizatave që duhet t'i respektojnë ato sipas VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, që përafron rregulloren (BE) 2018/1139 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Agjencia do t'i njoftojë gjithashtu këto masa autoriteteve kompetente kombëtare. Ofruesi i ATM/ANS i certifikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil gjithashtu do të komunikojë me autoritetin për çdo masë të marrë ndaj organizatës përkatëse.

NËNPJESA C CERTIFIKIMI, MBIKËQYRJA DHE ZBATIMI (DPO.AR.C)

DPO.AR.C.001 Lëshimi i miratimeve për organizatat e përfshira në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS

a) Pas marrjes së një aplikimi për lëshimin e një miratimi për një organizatë të përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS, Agjencia verifikon përputhjen e organizatës me kërkesat e përshkruara edhe në anekset II dhe III të rregullores që përcakton rregullat e detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror, sipas shtojcës I bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren 2023/1768, dhe në aneksin II të kësaj rregulloreje.

b) Agjencia mund të kërkojë çdo auditim, inspektim ose vlerësim që e sheh të nevojshëm përpara se të lëshojë miratimin me të gjithë informacionin përkatës të parashikuar edhe në shtojcën 1 të këtij aneksi.

c) Miratimi lëshohet për një kohëzgjatje të pakufizuar. Privilegjet në lidhje me aktivitetet që organizata është miratuar të kryejë do të specifikohen në kushtet e bashkangjitura miratimit.

1. Në lidhje me një organizatë të përfshirë në projektimin e pajisjeve ATM/ANS, kushtet specifikojnë llojin e punës së projektimit dhe kategoritë e pajisjeve ATM/ANS për të cilat organizata ka një miratim, si dhe privilegjet që organizata është miratuar të ushtrojë.

2. Në lidhje me një organizatë të përfshirë në prodhimin e pajisjeve ATM/ANS, kushtet specifikojnë fushën e punës dhe pajisjet ATM/ANS ose kategoritë e pajisjeve, ose të dyja, për të cilat mbajtësi i miratimit ka të drejtë të ushtrojë privilegjet.

d) Miratimi nuk jepet kur një gjetje e nivelit 1 të përmendur në DPO.AR.C.015 mbetet e hapur. Në rrethana të jashtëzakonshme, gjetjet e ndryshme nga niveli 1 do të vlerësohen dhe zbuten sipas nevojës nga organizata dhe një plan veprimi korrigjues për mbylljen e gjetjeve do të miratohet nga Agjencia përpara lëshimit të miratimit.

e) Çdo ndryshim i miratimit dhe i kushteve të tij miratohet nga Agjencia.

SHTOJCA 1
SPECIFIKIMET E MIRATIMEVE TË NJË ORGANIZATË TË PËRFSHIRË NË PROJEKTIMIN OSE PRODHIMIN E PAJISJEVE ATM/ANS

Në miratim specifikohet:

a) Agjencia si autoriteti kompetent që lëshon miratimin;

b) emri dhe adresa postare të aplikantit;

c) fushëveprimi i punës së aplikantit;

d) vendndodhja ku do të kryhen aktivitetet;

e) privilegjet shoqëruese për të cilat aplikanti është miratuar;

f) një konfirmim i konformitetit dhe pajtueshmërisë së aplikantit me kërkesat e zbatueshme;

g) data e lëshimit dhe vlefshmëria e miratimit;

h) kushtet ose kufizimet shtesë që i bashkëngjiten.

ANEKSI II
KËRKESAT PËR ORGANIZATAT E PËRFSHIRA NË PROJEKTIMIN OSE PRODHIMIN E PAJISJEVE ATM/ANS
(Pjesa-DPO.OR)

NËNPJESA A KËRKESA TË PËRGJITHSHME (DPO.OR.A)

DPO.OR.A.001 Fushëveprimi

Ky aneks përcakton kërkesat e përbashkëta në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e një aplikanti dhe të një mbajtësi të një miratimi organizate për projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS.

DPO.OR.A.005 Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik që ka demonstruar ose është i vendosur të demonstrojë aftësinë e tij për të projektuar ose prodhuar pajisje ATM/ANS në përputhje me pikën DPO.OR.A.010, mund të aplikojë për miratimin e një organizate projektimi ose prodhimi sipas kushteve të përcaktuara në këtë aneks.

DPO.OR.A.010 Aplikimi për miratimin dhe demonstrimin e aftësisë së një organizate projektimi ose prodhimi

a) Kërkesa për miratimin e një organizate të projektimit ose prodhimit bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Agjencia.

b) Për të marrë një miratim, një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore kur këto kërkesa janë të zbatueshme për projektimin ose prodhimin e sistemeve ATM/ANS dhe përbërësve të ATM/ANS që organizata kryen ose synon të kryejë.

DPO.OR.A.015 Dokumenti i organizatës

a) Një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS do të krijojë dhe mirëmbajë një dokument të organizatës, i cili ofron informacionin e mëposhtëm:

1. një deklaratë të nënshkruar nga menaxheri përgjegjës që konfirmon se dokumenti i organizatës dhe çdo manual shoqërues, që përcaktojnë pajtueshmërinë e organizatës me kërkesat do të respektohet në çdo kohë;

2. titullin dhe emrin e menaxherit (ve) kyç siç referohet në pikën DPO.OR.B.020;

3. detyrat dhe përgjegjësitë e menaxherit (ve), duke përfshirë çështjet për të cilat ata mund të merren drejtpërdrejt me Agjencinë në emër të organizatës;

4. një grafik organizativ që tregon linjat e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së menaxherëve në të gjithë organizatën, duke përfshirë një llogaridhënie të drejtpërdrejtë të menaxherit përgjegjës;

5. një përshkrim të përgjithshëm të burimeve të fuqisë punëtore të organizatës;

6. një përshkrim të përgjithshëm të objekteve të vendosura në çdo vendndodhje të specifikuar në miratimin e organizatës;

7. një përshkrim të përgjithshëm të fushës së punës së organizatës në lidhje me kushtet e miratimit;

8. procedura(t) për verifikimin dhe demonstrimin se projektimi i pajisjeve ATM/ANS, ose ndryshimet në të, përputhet me specifikimet dhe kërkesat e detajuara të zbatueshme siç përcaktohet në rregulloren mbi rregullat e detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror, sipas shtojcës I bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren 2023/1768, dhe nuk ka karakteristika të rrezikshme ose të pasigurta, sipas rastit;

9. procedurën për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave dhe të dhënave teknike, për çdo model të çdo pajisjeje ATM/ANS për të cilën është lëshuar një certifikatë ose deklaratë e përputhshmërisë së projektimit në përputhje me rregulloren mbi rregullat e detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror, sipas shtojcës I bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren 2023/1768, sipas rastit;

10. procedurat për njoftimin e Agjencisë për ndryshimet organizative;

11. procedurën e ndryshimit të dokumentit të organizatës;

12. një përshkrim, direkt ose me referencë të kryqëzuar, të sistemit dhe procedurës së menaxhimit të organizatës;

13. një përshkrim, të drejtpërdrejtë ose me referencë të kryqëzuar, të menaxhimit të kontraktorëve dhe procedurave të mbikëqyrjes të përmendura në pikën DPO.OR.B.015 të këtij aneksi.

b) Dokumenti i organizatës duhet të ndryshohet sipas nevojës për të ruajtur një përshkrim të përditësuar të organizatës dhe një kopje, duke përfshirë ndryshimet e tij, duhet t'i jepet Agjencisë.

c) Një aplikim për miratimin e ndryshimit të përmendur në pikën DPO.OR.B.005 të këtij aneksi bazohet në paraqitjen e ndryshimeve të propozuara në dokumentin e organizatës.

DPO.OR.A.025 Kohëzgjatja, vlefshmëria e vazhdueshme dhe privilegjet e miratimit të një organizate

a) Miratimi i një organizate mbetet i vlefshëm për një periudhë të pakufizuar kohore me kusht që:

1. organizata mbetet në përputhje me rregulloren (BE) 2018/1139 dhe aktet e deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj;

2. miratimi nuk është dorëzuar nga organizata ose pezulluar ose revokuar nga Agjencia.

b) Pas revokimit ose dorëzimit të miratimit, nëse është lëshuar në formë letre, ai i kthehet Agjencisë pa vonesë.

c) Mbajtësi i miratimit të një organizate ka të drejtë, brenda qëllimit të kushteve të miratimit të tij dhe sipas procedurave përkatëse të sistemit të menaxhimit të projektimit:

1. të klasifikojë ndryshimet në një pajisje ATM/ANS si 'të mëdha' ose 'të vogla';

2. të miratojë ndryshimet e vogla në një certifikatë dhe/ose deklaratë të pajisjes ATM/ANS të lëshuara sipas rregullores mbi përcaktimin e rregullave të detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror, sipas shtojcës I bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren 2023/1768;

3. të miratojë disa ndryshime të mëdha në një certifikatë të pajisjes ATM/ANS të lëshuar sipas rregullores mbi përcaktimin e rregullave të detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror, sipas shtojcës I bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren 2023/1768;

4. të lëshojë deklarata për pajtueshmërinë e projektimit të pajisjes ATM/ANS në përputhje me nenin 5 të rregullores mbi përcaktimin e rregullave të detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror, sipas shtojcës I bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren 2023/1768;

5. të lëshojë deklarata të pajtueshmërisë së pajisjes ATM/ANS në përputhje me nenin 6 të rregullores mbi përcaktimin e rregullave të detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror, sipas shtojcës I bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren 2023/1768.

DPO.OR.A.030 Lehtësimi dhe bashkëpunimi

a) Një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS do të lehtësojë inspektimet dhe auditimet e kryera nga Agjencia ose nga një subjekt i kualifikuar që vepron në emër të saj dhe do të bashkëpunojë sipas nevojës për ushtrimin efikas dhe efektiv të kompetencave të Agjencisë.

b) Një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS do të bashkëpunojë dhe mbështesë ofruesit e ATM/ANS duke përdorur pajisjet e saj ATM/ANS në procesin e demonstrimit të përputhshmërisë së tyre tek Autoriteti i Aviacionit Civil.

DPO.OR.A.035 Gjetjet dhe veprimet korrigjuese

Pas marrjes së njoftimit për gjetjet nga Agjencia, organizata e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS duhet të:

a) identifikojë shkakun rrënjësor të mospërputhjes;

b) përcaktojë një plan veprimi korrigjues;

c) demonstrojë zbatimin e veprimeve korrigjuese në mënyrë të kënaqshme për Agjencinë brenda periudhës kohore të propozuar dhe miratuar nga Agjencia, siç përcaktohet në shkronjën (e)(2) të pikës DPO.AR.C.015.

DPO.OR.A.040 Reagimi i menjëhershëm ndaj një problemi të sigurisë, mbrojtjes dhe ndërveprueshmërisë

Një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS do të zbatojë çdo masë sigurie dhe mbrojtjeje, përfshirë direktivat e pajisjeve ATM/ANS, të marra nga Agjencia në përputhje me pikat DPO.AR.A.010 dhe DPO.AR.A. 015.

DPO.OR.A.045 Dështimet, keqfunksionimet dhe defektet

a) Mbajtësi i një miratimi të lëshuar në përputhje me këtë rregullore, duhet:

1. të krijojë dhe të mbajë një sistem për mbledhjen, hetimin dhe analizimin e ngjarjeve dhe informacionit mbi dështimet, keqfunksionimet, defektet ose dukuri të tjera që kanë shkaktuar ose mund të shkaktojnë efekte negative në përputhjen e vazhdueshme të pajisjeve ATM/ANS me kërkesat e zbatueshme;

2. informojë të gjithë përdoruesit e njohur të pajisjeve ATM/ANS në fjalë dhe, sipas kërkesës, çdo person të caktuar sipas rregulloreve të tjera shoqëruese, për sistemin e krijuar në përputhje me pikën 1 dhe për mënyrën e dhënies së raporteve të tilla dhe informacionit për dështimet, keqfunksionimet, defektet ose dukuritë e tjera.

b) Për organizatat që kanë vendin e tyre kryesor të biznesit në një Shtet Anëtar, sistemi i krijuar në përputhje me shkronjën (a)(1) do të përfshijë dispozita për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve që plotësojnë kërkesat e rregulloreve (BE) nr. 376/2014 dhe (BE) nr. 2018/1139 dhe aktet e deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të tyre. Për organizatat që kanë vendin e tyre kryesor të biznesit në Shqipëri, sistemi i krijuar në përputhje me shkronjën (a)(1) do të përfshijë dispozita për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve që plotësojnë kërkesat e urdhrit të ministrit nr. 89, datë 5.5.2022 "Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

c) Mbajtësi i miratimit duhet t'i raportojë Agjencisë çdo dështim, mosfunksionim, defekt ose dukuri tjetër për të cilën ai është në dijeni, dhe që ka rezultuar ose mund të rezultojë në një gjendje rreziku, të pasigurt ose në funksion të dobët.

d) Për mbajtësit e miratimit që nuk kanë vendin e tyre kryesor të biznesit në një Shtet Anëtar të BE-së, raportet do të bëhen në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Agjencia, sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast dorëzohen jo më vonë se 72 orë pasi personi ose organizata ka marrë dijeni për ngjarjen e caktuar, përveç nëse rrethanat e jashtëzakonshme e pengojnë këtë.

e) Mbajtësi i miratimit do të hetojë një ngjarje që është raportuar sipas shkronjës "c", duke përfshirë mangësitë që kanë çuar në atë ngjarje, dhe i raporton Agjencisë rezultatet e hetimit të tij dhe çdo veprim që synon të ndërmarrë ose propozon të ndërmarrë për të korrigjuar këto mangësi.

DPO.OR.A.050 Transferueshmëria e miratimit

Një miratim i organizatës nuk është i transferueshëm, përveçse si rezultat i një ndryshimi në pronësinë e organizatës.

NËNPJESA B MENAXHIMI (DPO.OR.B)

DPO.OR.B.001 Sistemi i menaxhimit

a) Një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS duhet të zbatojë dhe mirëmbajë një sistem menaxhimi që përfshin sa vijon:

1. linja të përcaktuara qartë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies në të gjithë organizatën e saj, duke përfshirë llogaridhënien e drejtpërdrejtë të menaxherit përgjegjës;

2. një përshkrim të filozofisë dhe parimeve të përgjithshme të organizatës, të cilat së bashku përbëjnë një politikë, të nënshkruar nga menaxheri përgjegjës;

3. mjetet për të verifikuar performancën e organizatës në dritën e treguesve të performancës dhe objektivave të performancës së sistemit të menaxhimit;

4. një proces për të identifikuar ndryshimet brenda organizatës dhe kontekstin në të cilin ajo operon, të cilat mund të ndikojnë në proceset, procedurat dhe produktet e caktuara dhe, kur është e nevojshme, të ndryshojë sistemin e menaxhimit për të përshtatur ato ndryshime;

5. një proces për identifikimin e fushës së ndryshimeve në pajisjet ATM/ANS dhe rrezikun shoqërues;

6. një proces për rishikimin e sistemit të menaxhimit, identifikimin e shkaqeve të performancës nën standard të sistemit të menaxhimit, përcaktimin e implikimeve të një performance të tillë nën standard dhe eliminimin ose zbutjen e shkaqeve të tilla;

7. një proces për të siguruar që personeli i organizatës është i trajnuar dhe kompetent për të kryer detyrat e tyre në një mënyrë të sigurt, efikase, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme; në këtë kontekst, organizata do të vendosë politika për rekrutimin dhe trajnimin e personelit të saj;

8. një mjet formal për komunikim që siguron që i gjithë personeli i organizatës është plotësisht i vetëdijshëm për sistemin e menaxhimit që lejon komunikimin e informacionit kritik dhe që bën të mundur shpjegimin përse ndërmerren veprime të veçanta dhe pse procedurat futen ose ndryshohen;

9. për sa u përket aktiviteteve të projektimit, procedurat, për:

i) projektimin e pajisjeve ATM/ANS dhe për ndryshimet në projektimin e tij;

ii) sigurinë se projektimi i pajisjes ATM/ANS, ose ndryshimet në projektimin e saj, përputhen me specifikimet e zbatueshme, duke përfshirë funksionin e pavarur të kontrollit të demonstrimit të pajtueshmërisë, mbi bazën e të cilit organizata dorëzon deklaratat e pajtueshmërisë dhe dokumentacionin përkatës në Agjenci;

iii) verifikimin e pranueshmërisë së elementeve të pajisjes ATM/ANS të projektuar ose të detyrave të kryera nga organizatat e kontraktuara të përmendura në pikën DPO.OR.B.015;

iv) sigurinë se personeli i përfshirë në projektimin e pajisjeve ATM/ANS është në numër të mjaftueshëm dhe është i trajnuar dhe kompetent, si dhe është autorizuar të kryejë përgjegjësitë e tij të caktuara;

v) koordinimin e ngushtë dhe efikas ndërmjet departamenteve dhe brenda departamenteve;

10. për sa u përket aktiviteteve prodhuese, procedurat për:

i) lëshimin dhe miratimin e dokumenteve, ose ndryshimet në to;

ii) auditimet e vlerësimit dhe kontrolli i organizatave të kontraktuara të përmendura në pikën DPO.OR.B.015;

iii) verifikimin që materialet dhe pajisjet hyrëse, duke përfshirë furnizimin e artikujve ose artikujve të rinj të përdorur nga blerësit e pajisjeve ATM/ANS, janë siç specifikohet në të dhënat e projektimit të zbatueshëm;

iv) verifikimin që pajisjet ATM/ANS janë në përputhje me të dhënat e projektimit të zbatueshëm;

v) identifikimin dhe gjurmueshmërinë;

vi) proceset organizative;

vii) inspektimin dhe testimin;

viii) kalibrimin e veglave dhe pajisjeve të testimit;

ix) kontrollin e artikujve jo konform;

x) koordinimin me aplikantin ose mbajtësin e miratimit të projektimit;

xi) plotësimin dhe mbajtjen e të dhënave të punës së kryer;

xii) lëshimin e dokumenteve të lirimit;

xiii) trajtimin, ruajtjen dhe paketimin e pajisjeve ATM/ANS.

b) Një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS duhet të dokumentojë të gjitha proceset kyçe të sistemit të menaxhimit, duke përfshirë një proces për ndërgjegjësimin e personelit për përgjegjësitë e tyre dhe procedurën për ndryshimin e këtyre proceseve.

c) Një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjes ATM/ANS do të krijojë një funksion brenda sistemit të saj të menaxhimit për të monitoruar përputhjen e saj me kërkesat e zbatueshme dhe përshtatshmërinë e procedurave të vendosura. Monitorimi i përputhshmërisë do të përfshijë një sistem reagimi të gjetjeve për menaxherin përgjegjës për të siguruar zbatimin efektiv të veprimeve korrigjuese, sipas nevojës.

d) Sistemi i menaxhimit duhet të jetë proporcional me madhësinë e organizatës së përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS dhe kompleksitetin e aktiviteteve të saj, duke marrë parasysh risqet dhe rreziqet shoqëruese të qenësishme në këto aktivitete.

e) Përveç sistemit të menaxhimit të përmendur në shkronjën "a", organizata e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS do të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit në përputhje me rregulloren zbatuese (BE) 2023/203 kur të jetë e zbatueshme në legjislacionin e brendshëm për të siguruar menaxhimin e duhur të rreziqeve të sigurisë së informacionit që mund të kenë ndikim në sigurinë e aviacionit.

DPO.OR.B.005 Menaxhimi i ndryshimit

a) Pas lëshimit të miratimit të një organizate, çdo ndryshim i rëndësishëm në sistemin e menaxhimit do të miratohet nga Agjencia përpara se të zbatohet, përveç nëse një ndryshim i tillë njoftohet dhe menaxhohet në përputhje me një procedurë të miratuar nga Agjencia. Organizata duhet t'i paraqesë Agjencisë një kërkesë për miratim që dëshmon përputhshmërinë e vazhdueshme me kërkesat e zbatueshme.

b) Çdo ndryshim në pajisjet ATM/ANS do njoftohet dhe miratohet nga Agjencia përpara se të zbatohet, përveç nëse një ndryshim i tillë menaxhohet në përputhje me procedurën e menaxhimit të ndryshimit të miratuar nga Agjencia. Kjo procedurë e menaxhimit të ndryshimeve do të përcaktojë klasifikimin e ndryshimeve në pajisjet ATM/ANS dhe do të përshkruajë se si këto ndryshime do të njoftohen dhe menaxhohen.

DPO.OR.B.010 Kërkesat e faciliteteve

Një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS duhet të sigurojë që facilitetet/strukturat dhe pajisjet e saj, duke përfshirë facilitetet dhe pajisjet e testimit, janë të duhura dhe të përshtatshme për të kryer dhe menaxhuar të gjitha detyrat dhe aktivitetet e saj në përputhje me kërkesat e zbatueshme.

DPO.OR.B.015 Aktivitetet e kontraktuara

a) Aktivitetet e kontraktuara përfshijnë të gjitha ato aktivitete që janë brenda fushëveprimit të aktiviteteve të organizatës, në përputhje me kushtet e certifikatës, të cilat kryhen nga organizata të tjera ose të certifikuara vetë për të kryer aktivitete të tilla ose, nëse nuk janë të certifikuara, punojnë nën mbikëqyrjen e një organizate të tillë. Një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS duhet të sigurojë që kur kontrakton ndonjë pjesë të aktiviteteve të saj ose kur blen ndonjë pjesë të aktiviteteve të saj nga organizata të jashtme, aktiviteti i kontraktuar ose i blerë, sipas rastit, është në përputhje me kërkesat e zbatueshme.

b) Kur një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS kontrakton ndonjë pjesë të aktiviteteve të saj me një organizatë që nuk është vetë e certifikuar në përputhje me këtë rregullore për të kryer aktivitete të tilla, ajo duhet të sigurojë që organizata e kontraktuar të punojë nën mbikëqyrjen e saj. Një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS do të sigurojë që Agjencisë t'i jepet akses në organizatën e kontraktuar për të përcaktuar pajtueshmërinë e saj të vazhdueshme me kërkesat e zbatueshme të kësaj rregulloreje.

DPO.OR.B.020 Kërkesat për personelin

a) Një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS do të emërojë një menaxher përgjegjës, i cili ka autoritetin për të siguruar që të gjitha aktivitetet mund të financohen dhe kryhen në përputhje me kërkesat e zbatueshme të kësaj rregulloreje. Menaxheri përgjegjës do të jetë përgjegjës për krijimin dhe mbajtjen e një sistemi efektiv të menaxhimit.

b) Autoriteti, detyrat dhe përgjegjësitë e personave të emëruar në detyrë, në veçanti të personelit menaxhues përgjegjës për sigurinë, cilësinë, financat dhe burimet njerëzore, gjithashtu do të përcaktohen.

DPO.OR.B.025 Ruajtja e të dhënave

a) Një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS do të krijojë një sistem të mbajtjes së të dhënave që lejon ruajtjen e duhur të të dhënave dhe gjurmueshmërinë e besueshme të të gjitha aktiviteteve të saj, duke mbuluar veçanërisht të gjitha elementet e treguara në pikën DPO.OR. B.001.

b) Formati dhe periudha e ruajtjes së të dhënave të përmendura në shkronjën "a" do të specifikohen në procedurat e sistemit të menaxhimit të organizatës.

c) Të dhënat duhet të ruhen në një mënyrë që garanton mbrojtjen e tyre kundër dëmtimit, ndryshimit dhe vjedhjes.

d) Një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS duhet të mbajë një regjistër të pajisjeve ATM/ANS që të vendosura.

NËNPJESA C KËRKESAT TEKNIKE (DPO.OR.C)

DPO.OR.C.001 Organizatat e përfshira në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS

a) Një aplikant dhe një mbajtës i një miratimi të një organizate projektimi ose prodhimi për pajisjet ATM/ANS do të ketë të drejtë, sipas rastit, për një nga sa vijon:

1. të mbajë ose të aplikojë për lëshimin e një certifikate për projektimin e pajisjeve ATM/ANS;

2. të lëshojë një deklaratë të pajtueshmërisë së projektimit për pajisjet ATM/ANS;

3. lëshojë një deklaratë përputhshmërie për pajisjet ATM/ANS, me kërkesë të një ofruesi të ATM/ANS.

b) Për sa u përket aktiviteteve të projektimit, një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS, duhet:

1. të lëshojë një deklaratë për pajtueshmërinë e projektimit për pajisjet ATM/ANS, sipas rastit;

2. të nxjerrë të dhëna dhe informacione, duke përfshirë udhëzimet, nën përgjegjësinë e saj brenda fushëveprimit të kushteve të miratimit të përcaktuara nga Agjencia;

3. të përgatisë dhe të mbajë, për çdo model të secilës pjesë për të cilën është lëshuar një deklaratë e pajisjeve ATM/ANS, një skedar të përditësuar me të dhëna dhe regjistrime të plota teknike.

c) Për sa u përket aktiviteteve të prodhimit, një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS, duhet:

1. të prodhojë çdo artikull duke siguruar që pajisja e kompletuar ATM/ANS është në përputhje me të dhënat e saj të projektimit dhe është e sigurt për instalim;

2. të përgatisë dhe të mbajë, për çdo model të secilës pjesë për të cilën është lëshuar një deklaratë e pajisjeve ATM/ANS, një skedar të përditësuar me të dhëna të plota teknike dhe regjistrime;

3. të përgatisë, mirëmbajë dhe përditësojë kopjet kryesore të të gjitha manualeve të kërkuara nga specifikimet e deklarimit të zbatueshëm për pajisjen e caktuar;

4. të vërë në dispozicion të përdoruesve të pajisjeve ATM/ANS dhe Agjencisë sipas kërkesës, ato udhëzime për përshtatshmërinë e vazhdueshme të nevojshme për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve ATM/ANS, dhe ndryshimet në këto udhëzime;

5. të shënojë çdo artikull;

6. të vazhdojë të jetë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në këtë rregullore.

d) Përveç shkronjës "c", një organizatë e përfshirë në prodhimin e pajisjeve ATM/ANS ka të drejtë, brenda fushëveprimit të kushteve të miratimit të saj, të përcaktojë që çdo pajisje e kompletuar ATM/ANS është në përputhje me të dhënat e zbatueshme të projektimit dhe është në gjendje për funksionim të sigurt përpara lëshimit të një formulari të lëshimit EASA që deklaron se pajisja ATM/ANS është prodhuar në përputhje me kërkesat e zbatueshme të kësaj rregulloreje dhe me të dhënat e zbatueshme të projektimit.

e) Formulari i lëshuar nga EASA referuar në shkronjën "d" për çdo pajisje ATM/ANS të prodhuar përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

1. një përshkrim të pajisjes ATM/ANS;

2. numrin/kodin e pjesës së pajisjes ATM/ANS;

3. numrin serial të pajisjes ATM/ANS;

4. një deklaratë që pajisja ATM/ANS është prodhuar në përputhje me të dhënat e zbatueshme të projektimit dhe është në gjendje për funksionim të sigurt;

5. një referencë të certifikatës ose deklaratës së përputhshmërisë së projektimit.

DPO.OR.C.005 Koordinimi

Një organizatë e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS duhet të sigurojë:

a) koordinimin e kënaqshëm, me mënyrat e duhura, ndërmjet aktiviteteve të projektimit dhe prodhimit, sipas rastit;

b) koordinimin e kënaqshëm dhe mbështetjen e duhur për ofruesit përkatës të ATM/ANS dhe ndërmarrjet e aviacionit në lidhje me përshtatshmërinë e vazhdueshme të pajisjeve ATM/ANS, sipas rastit.

DPO.OR.C.010 Direktivat e pajisjeve ATM/ANS

Kur Agjencia lëshon një direktivë për pajisjet ATM/ANS, në përputhje me pikën ATM/ANS.EQMT.CERT.065 të aneksit II të rregullores mbi përcaktimin e rregullave të detajuara për certifikimin dhe deklarimin e sistemeve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror, sipas shtojcës I bashkëlidhur këtij urdhri që përafron rregulloren 2023/1768, organizata e përfshirë në projektimin ose prodhimin e pajisjeve ATM/ANS duhet:

a) të propozojë një veprim të duhur korrigjues dhe ta dorëzojë atë së bashku me detajet në Agjenci për miratim;

b) pas miratimit nga Agjencia të propozimit të përmendur në shkronjën "a", të vërë në dispozicion të gjithë përdoruesve ose pronarëve të njohur të pajisjeve ATM/ANS të dhënat e duhura përshkruese dhe udhëzimet e realizimit dhe, sipas kërkesës, të çdo personi të cilit i kërkohet që të jetë në përputhje me direktivën e pajisjeve ATM/ ANS.